

RREGULLORJA E PUNËS

Rrjeti i Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financa dhe Integrim Evropian të Ballkanit Perëndimor

I. MISIONI

- 1.1 Rrjeti i Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financa dhe Integrim Evropian i Ballkanit Perëndimor siguron platformë për dialog efektiv, përfshirës mes pjesëmarrësve parlamentar për përparimin e bashkëpunimit mes komisioneve parlamentare dhe parlamenteve nga Ballkani Perëndimor dhe përforcimin e rolit të tyre në promovimin e konkurrencës, rritjes ekonomike dhe Integrimin Evropian.

II. FUNKSIONET E KËSHILLIT

- 2.1 Veprimtaria kryesore e këshillit është të siguron drejtimin e punës dhe mbikëqyrjen e organizatës ndërmjet takimeve vjetore të Rrjetit.
- 2.2 Këshilli miraton Strategjinë dhe programin e punës të rrjetit, ndjek përparimin gjatë vitit dhe ofron propozime dhe nisma për zhvillim të mëtutjeshëm të bashkëpunimeve rajonale.

III. PËRFAQËSIMI

- 3.1 Çdo kuvend pjesëmarrës emëron nga një (1) përfaqësues – anëtar i këshillit dhe një (1) zëvendës përfaqësues. Në rast të mungesës, përfaqësuesi mund të zëvendësohet nga një zëvendës përfaqësues.
- 3.2 Emrat e përfaqësuesve, zëvendës-përfaqësuesve do të dorëzohen në sekretariatit e përkohshëm të Rrjetit me mandat prej 2 vjetësh. Termi aktual i këshillit është me kohëzgjatje prej 19 korrik 2017 deri më 18 korrik 2019.
- 3.3 Kryesimi mbi këshillin ndryshohet çdo gjashtë (6) muaj në pajtim me Aktin për organizimin e Rrjetit.
- 3.4 Në rast të mungesës së kryetarit në ndonjë takimi ose me kërkesë të vetë kryetarit, takimin e kryeson zëvendës-kryetari.
- 3.5 Në rast të ndërprerjes së pjesëmarrjes të anëtarëve të bordit të Rrjetit në Komisionin Parlamentar amë për çfarëdo arsye, komisioni i autorizuar do të emërojë një anëtar të ri të këshillit brenda 30 ditësh dhe të paraqesë emrin e tij/saj tek sekretariati i këshillit.

IV. TAKIMET E KËSHILLIT

- 4.1 Data e takimit të këshillit, sipas rregullës, caktohet në takimin paraprak të këshillit.
- 4.2 Këshilli do të synojë të takohet së paku njëherë në çdo tre muaj.
- 4.3 Mund të mbahen takime shtesë me propozim të kryetarit të këshillit.
- 4.4 Zakonisht, takimet mbahen në parlamentin amë të kryesuesit ose në zyrën e Ballkaint Perëndimor të Fondacionit Westminster për Demokraci, derisa nuk themelohet zyrtarisht sekretariat i Rrjetit.

V. RENDI DITOR I TAKIMIT TË KËSHILLIT

- 5.1 Në bazë të udhëzimeve të Kryetarit, Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) do t'i njofton anëtarët e këshillit për propozim versionin e rendit ditor dhe për të gjitha dokumentet e nevojshme, nëse është e mundur, së paku 2 javë para datës së takimit.
- 5.2 Propozim-versioni i rendit ditor të një takimi mund të përfshijë:
 - a) Artikuj që janë të shënuara në programin e punës të miratuar nga ana e këshillit;
 - b) Artikuj të propozuar nga ana e Grupeve Punuese Parlamentare;
 - c) Çdo artikull tjetër i propozuar nga ndonjë pjesëmarrës nëse i njëjti është në pajtim me Rregulloren e Punës së këshillit.
- 5.3 Dokumentet lidhur me artikujt nga rendi ditor duhet të jenë në dispozicion në gjuhën angleze, si rregull, së paku dy (2) javë para takimit dhe/ose, nëse lejojnë burimet, në versione të përkthyer në gjuhët e parlamenteve-pjesëmarrëse së paku një (1) javë para takimit.
- 5.4 Në raste të jashtëzakonshme, dokumentet mund të dorëzohen në takim, por në këtë rast të njëjtat mund të përdoren vetëm për shqyrtim paraprak, përveç nëse këshilli nuk vendos ndryshe.

VI. KRYERJA E DETYRËS

- 6.1 Takimet e këshillit do të mbahen nëse ekziston kuorum. Me kuorum nënkuptohet pjesëmarrje e 5 deri më 8 parlamenteve pjesëmarrëse.
- 6.2 Këshilli miraton raport të takimit në bazë të propozim-versionit të përgatitur nga ana e sekretariatit të Rrjetit.
- 6.3 Çdo përfaqësues ka të drejtë të shprehë qëndrimin e tyre në raportin për takimin.

VII. VOTIMI

- 7.1 Çdo parlament pjesëmarrës ka të drejtë për një votë në këshill.
- 7.2 Vendimet e këshillit merren me anë të konsensusit. Nëse ndonjë problem ka të bëjë vetëm me disa palë të caktuara, vendimet merren me konsensus të atyre palëve.
- 7.3 Në rast të problemit organizativ lidhur me takimet e këshillit, këshilli merr vendime me shumicë të dy të tretave (2/3) të pjesëmarrësve që votojnë.

- 7.4 Këshilli zakonisht voton me ngritjen e dorës. Nëse ndonjëri nga pjesëmarrësit kërkon, mund të kryhet lexim me zë sipas rendit të alfabetit të emrave të pjesëmarrësve parlamentar.

VIII. GRUPET E PUNËS

- 8.1 Këshilli ka kompetencë për formim të grupeve të punës.
8.2 Çdo grup punues kryesohet një anëtar i këshillit.
8.3 Kryesuesi i grupit të punës është përgjegjës për ofrimin e komenteve (feedback) këshillit.

IX. ROLI I SEKRETARIATIT

- 9.1 Sekretariati është përgjegjës për funksionet administrative të organizatës.
9.2 Fondacioni Westminster për Demokraci e merr përsipër rolin e sekretariatit të përkohshëm, përveç nëse Rrjeti vendos ndryshe.

X. GJUHA E PUNËS

- 10.1 Gjuha angleze dhe të gjitha gjuhët zyrtare të parlamenteve pjesëmarrëse janë gjuhët e punës të këshillit.
10.2 Gjatë kohës së takimeve të këshillit, nëse kërkohet do të sigurohen shërbime të interpretimit derisa burimet dhe mundësitë e lejojnë këtë.